

RELACION

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË VEÇANTË PËR NEGOCIIMIN DHE EKZEKUTIMIN E KONTRATËS ME SHOQËRINË “BECHTEL INTERNATIONAL”, INC., PËR PROJEKTIMIN DHE NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË SKAVICËS”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Me anë të këtij projektligji synohet që të miratohet një procedurë e veçantë për negociimin dhe ekzekutimin e kontratës me partnerin strategjik “*Bechtel Internacional*”, Inc., për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës bazuar në shprehjen e interesit paraprak të depozituar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Palët shprehin interesin e tyre për bashkëpunim në fushat e projektimit, ndërtimit dhe sigurimit të financimit për realizimin e projektit në zonën e Dibrës. Kontrata e fazës së parë dhe kontrata e fazës së dytë do të nënshkruhen nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare në cilësinë e autoritetit kontraktues ndërkohë që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do asistojë gjithë procesin.

Procedura e negociimit për finalizimin e kontratës së fazës së parë do të zhvillohet nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare dhe do të fillojë brenda 5 ditëve nga dita kur shoqëria “*Bechtel*” do të dorëzojë pranë Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare propozimin zyrtar lidhur me kontratën e fazës së parë. Procedura e negociimit për fazën e dytë të kontratës do të zhvillohet nga Komisioni i Negociimit i krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave me përfaqësues të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nga ministri të tjera të linjës ose organe të tjera sipas përcaktimit në këtë vendim.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është i parashikuar në planin analitik të projektakteve për vitin 2021.

III. PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME TË KËTIJ PROJEKTAKTI

Duke qenë se sektori i energjisë është me interes kombëtar dhe thelbësor për Shqipërinë, si dhe në vijimësi të interesit të shprehur ndërmjet palëve për të zhvilluar variante të infrastrukturës “*smart*” për vendin tonë, në funksion të këtij qëllimi janë nënshkruar këto memorandume:

1. Memorandumi i bashkëpunimit ekonomik, për projektet dhe blerjet në vendin tonë, ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, miratuar me vendimin nr.785, datë 7.10.2020, të Këshillit të Ministrave.
2. Memorandumi i mirëkuptimit për bashkëpunim lidhur me projektin e HEC Skavicë, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë dhe *Bechtel International Inc.*, nënshkruar më 3 tetor 2020.

Palët shprehin interesin e tyre që kontrata të përfshijë bashkëpunimin në fushat e projektimit, ndërtimit dhe sigurimit të financimit për realizimin e projektit në zonën e Dibrës.

Gjithashtu, palët shprehin interes që, krahas bashkëpunimit të tyre në fushat e projektimit dhe zbatimit të punimeve, të trajtojnë edhe financimin e duhur të projektit, që të jetë i pranueshëm për qeverinë e Republikës së Shqipërisë.

Në vijim të sa më sipër, është vlerësuar të jetë shoqëria “*Bechtel International*”, *Inc.*, pala që do të realizojë projektin e HEC Skavicës, sipas procedurës së parashikuar në këtë projektligj.

Nëpërmjet miratimit të këtij projektligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, pritet realizimi i një vepre energjetike, bazuar në kontratën e lidhur ndërmjet shoqërisë “*Bechtel*” dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, e cila do të jetë një kontratë e tipit “*Engineering, procurement, and construction (EPC)*”, ku kjo shoqëri do të marrë masat e nevojshme për projektimin dhe ndërtimin e kësaj vepre.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me programin e qeverisë shqiptare.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projektligj nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në nenin 1 parashikohet se qëllimi i këtij ligji është të autorizojë dhe të përcaktojë procedurën e veçantë për negociimin, ekzekutimin dhe miratimin e kontratës me partnerin strategjik *Bechtel International, Inc.*, ose një filial të tij, për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, bazuar në shprehjen e interesit paraprak të depozituar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Neni 2 parashikon strukturën e kontratës, e cila do të ndahet në dy faza:

- a) kontrata e fazës së parë, e cila do të përfshijë aktivitetet paraprake të punës që do t'i mundësojnë *Bechtel* të paraqesë një propozim tek Autoriteti Kontraktues për kontratën e fazës së dytë dhe të ndihmojë këtë të fundit dhe qeverinë shqiptare në sigurimin e mbështetjes financiare për projektin, dhe
- b) kontrata e fazës së dytë që konsiston në projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës.

Neni 3 përcakton procedurat që do të ndiqen për negociimin e kësaj kontrate. Kontrata e fazës së parë dhe kontrata e fazës së dytë do të nënshkruhen nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare në cilësinë e autoritetit kontraktues. Procedura e negociimit për fazën e dytë të kontratës do të zhvillohet nga Komisioni i Negociimit i krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave me përfaqësues të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nga ministri të tjera të linjës ose organe të tjera sipas përcaktimit në këtë vendim.

Komisioni i Negociimit do të fillojë punë menjëherë pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për krijimin e tij, vendim ky i cili do të përcaktojë anëtarësinë e Komisionit, kompetencat, objektin e punës dhe procedurën e vendimmarrjes. Komisioni i Negociimit të kontratës mund të asistohet nga një konsulent, i përzgjedhur nga Avokatura e Shtetit, sipas procedurave të përcaktuara për këtë qëllim për Avokaturën e Shtetit. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do asistojë gjithë procesin.

Në nenin 4 përcaktohet faza e nënshkrimit dhe miratimit të kontratës, ku autoriteti kontraktues dhe *Bechtel* do të nënshkruajnë kontratën e fazës së parë

brenda 3 ditësh pune nga data e finalizimit të kushteve të saj. Kontrata e fazës së dytë do të nënshkruhet nga autoriteti kontraktues brenda 3 ditësh pune nga data e finalizimit të kushteve të saj nga Komisionin i Negociimit. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do t'i paraqesë për miratim Këshillit të Ministrave kontratën e nënshkruar në lidhje me fazën e parë të projektit brenda 3 ditësh pune nga nënshkrimi i saj. Data e hyrjes në fuqi të kontratës për fazën e parë të projektit do të jetë data e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave që miraton kontratën.

Në nenin 5 parashikohen hapat që do ndërmerren për realizimin e projektit.

Në nenin 6 parashikohet që ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë vlerësohet se ky projektligj nuk hyn ndër aktet që bien ndesh me vendimmarrjen e KQZ-së, pasi, së pari, sikurse është referuar në këtë relacion, ky projekt është nisur që në muajin tetor 2020, me anë të nënshkrimit të marrëveshjeve nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Gjithashtu, ky projektligj nuk synon dhënien e një të drejte me koncesion/PPP, sikurse është referuar në vendimin e KQZ-së, por për krijimin e hapësirës ligjore të kontraktimit direkt të shoqërisë “Bechtel” për projektimin dhe ndërtimin e HEC Skavicës, në përputhje me kushtet e parashikuara në projektligj.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj në këtë fazë nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit. Nga zbatimi i tij do mundësohet, ndër të tjera, përcaktimi i kostove

financiare për realizimin e HEC Skavica dhe gjetja e fondeve të nevojshme për implementimin e tij.

KËSHILLI I MINISTRAVE